

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.03/L-079, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2006/50, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private duke përfshirë pronën Bujqësore dhe ate Komerciale, kolegji në përbërje nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Nebojša Boričić, gjyqtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike **të palës ankuese;**

**Č. J. M., R. Srbija**

Kundër:

**Xh. S., nga K. Viti**

**Palë përgjegjëse në kërkesë, /dhe në ankesë/.**

Duke vendosur lidhur me ankesën e paraqitur, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 Mars 2015, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA27076), pas shqyrtimit të mbajtur me datë, 15 Janar 2020, merr;

#### **AKTGJYKIM**

- 1. Refuzohet si e pabazuar Ankesa e parashtruar Č. J. M., paraqitur kundër Vendimit KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 Mars 2015, (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA27076).**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/267/2015, i datës 30 Mars 2015.**

#### **Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:**

1. Me datë 12 Shkurt 2007, Č. J. M. ( tutje; pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës ( tutje: AKP), në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare të nënës së tij të ndjerë R. M., si bartëse e pretenduar e të drejtës pronësore (tutje BDP). Në kërkesë saktëson se nëna e tij R. M. është bashkëpronare me 1/2 pjesë ideale, të pronave të paluajtshme në f. ..., K. Viti, përkatësisht e ngastrave kadastrale, nr..., tokë e punueshme në sipërfaqe prej 0.87.49ha., ngastrës kadastrale nr. ..., me kulturë livadh në sipërfaqe prej 1.01.87ha., dhe ngastrës kadastrale nr. ..., me kulturë kullosë, në sipërfaqe prej 2.10.90ha., të cilat ndodhen në potezin Vakufski zabran.
2. Në kërkesë sqaron se nëna e tij e ndjerë, pronat e kërkuara i kishte trashëguar së bashku me vëllain e saj M. G. , i lindur në V. R. Mali i ZI, nga babai i saj P. G. i cili kishte vdekur në

vitin 1950, në bazë të vendimit mbi trashëgimin të vitit 1953. Pronat njëjta ishin të përditësuara në bazë të fletës poseduese nr. ..., sipas kadastrit të zhvendosur në Serbi.

3. Pala ankuese tregon se posedimin e pronës së kërkuar e ka humbur si pasojë e rrethanave që ndërlihen me konfliktin në Kosovë, të ndodhur në vitet 1998/99, si datë të humbjes e cek datën 15 Qershor 1999, ndërsa nuk ka informata lidhur me gjendjen aktuale të pronave të kërkuara, andaj kërkon konfirmimin e të drejtës pronësore dhe ri posedimin e pronës së kërkuar.
4. Në mbështetje të kërkesës së tij në AKP, ka dorëzuar dokumentet si në vijim;
  - Vendimin e Trashëgimisë, Nr. O.nr..., të dt. 21.03.1951, lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Viti për mes së cilit BDP e pretenduar, (nëna e tij) dhe vëllai i saj Mina Gojković, i kanë trashëguar pronat e kërkuara dhe të tjerat si bashkëpronarë me nga ½, pjesë ideale pas vdekjes së babait të tyre P. G...
  - Përshkrimin e Fletës Poseduese nr. ..., të dt. 16.04.2002, të lëshuar nga kadastrit i zhvendosur në Serbi, Enti Republikan për Gjeodezi Beograd, sipas së cilës nëna e palës ankuese, dhe daja i tij, janë bashkëpronarë me ½ pjesë ideale, të ngastrave të kërkuara me kërkesë.
  - Vendimin e Gjykatës Komunale në Viti, R nr. ..., të dt. 26.10.1994, që tregon se nëna e palës kërkuese dhe fëmijët e vëllait të saj, (dajës së palës ankuese) S. G., M. R dhe J. G., i kanë ndarë pronat e paraqitura si në Fletën Poseduese, nr... Sipas këtij dokumenti pronat e kërkuara ishin nën ndarë, sipas kësaj ndarje BDP e pretenduar, ishte bërë pronare e vetme e ngastrave kad. nr. ..., në sipërf. prej 0.45.20ha., ngastrës kad. nr..., në sipërfaqe prej 0.75.63ha., dhe ngastrës kadastrale nr. ..., në sipërfaqe prej 1.12.08ha.
  - Vendimin e plotfuqishëm të trashëgimisë nr. ..., të dt. 06.07.2011, të Gjykatës Themelore në Kruševac, sipas së cilit pala ankuese i ka trashëguar pronat të cilat ishin në emër të nënës së tij, sipas Fletës poseduese nr. ..., duke përfshirë edhe pronat e kërkuara në të cilat ajo ishte bashkëpronare me ½, pjesë ideale.
  - Më pas pala ankuese kishte paraqitur deklaratë me shkrim me datë 20.08.2014, me të cilën e njofton AKP-në, se nëna e tij ishte shpallur pronare e vetme e ngastrave kad. ..., nr. ..., dhe ..., sipas vendimit të cekur më lartë të gjykatës për ndarje të vitit 1994, ndërsa këto prona ai i kishte trashëguar sipas vendimit të vitit 2011. Sipas kësaj deklarate ai kërkon që tutje kërkesa e tij të përpunohet për parcelat dhe sipërfaqet sipas vendimit të ndarjes të vitit 1994, të cilat ai i kishte trashëguar.
5. Nga AKP-ja, njoftimi i kërkesës për pronën e kërkuar, ishte bërë me datë 16.07.2007, prona ishte gjetur e pa punuar-livadhe dhe e pa uzurpuar. Konfirmimi i pronës së notifikuar ishte bërë me datë 17.06.2010, për mes publikimit në gazetën nr. ..., Buletinin e UNHCR, dhe në organet e tjera të Komunës dhe në fshatin Gërmovë.

6. Xh. S., (tutje pala përgjegjëse PP), ishte gjetur si uzurpues i pjesës së ngastrës kadastrale nr. ..., në të cilën kishte ndërtuar shtëpi. Ai pretendon se sipërfaqen prej 0.25.00ha., të ngastrës kad. 812, e ka blerë nga P. P., dhe për këtë pjesë pretendon të drejtë ligjore. I njëjti e mohon se shtëpinë e ka ndërtuar në pjesën e pronës së palës ankuese.
7. Živojin Dinčić-tutje pala kërkuese nr. ..., (PK2), në cilësinë e bartësit të drejtë pronësore, kishte parashtruar në AKP, kërkesa ligjërisht konkurruese, dhe ate: Kërkesa KPA36835,( përfshinë ngastrën kad.nr. ...), KPA36836,( ngastrën kad. nr. ...), dhe KPA36837(ngastrën kad....).
8. Ž. D., kishte theksuar se ai i ka blerë pronat e kërkuara të cekura si më lartë, nga xhaxhai i PK1. Më vonë djali i PK2, kishte konfirmuar se babai i tij kishte blerë dy prona në vitin 1975, dhe ate sipërfaqen prej 0.78.00ha, nga ngastra kad. ..., nga xhaxhai i Č. M., (pala ankuese) dhe në vitin 1994,kishte blerë sipërfaqen prej 0.88.00,ha., por nuk ishte i qartë se në cilën ngastër kadastrale ishte kjo sipërfaqe të cilën e kishin blerë nga S. G.
9. Në mbështetje të kërkesës së tij konkurruese PK2, kishte paraqitur, Fletën poseduese nr. ., të vitit 2005 sipas së cilës daja i palës ankuese është pronar i vetëm i ngastrave të kërkuara. Kjo fletë poseduese nga AKP ishte verifikuar pozitivisht.
10. Sipas verifikimit-raportit të konsoliduar të sekretarisë së AKP-së, të dt.19.09.2014, të dokumenteve të paraqitura nga pala ankuese, Vendimi i trashëgimisë i vitit 1953, ishte verifikuar negativisht, dokumenti nuk ishte gjetur në organet kompetente e po ashtu edhe Vendimi i Gjykatës për ndarje i vitit 1994 ishte verifikuar negativisht, nuk ishte gjetur në gjykatën kompetente të lëshimit e as në Serbi, po ashtu ky dokument nuk kishte vulën e plotfuqishmërisë. Fleta poseduese ishte verifikuar pozitivisht në kadastrën e zhvendosur. Ndërsa Vendimi i trashëgimisë i vitit 2011, ishte verifikuar pozitivisht dhe i plotfuqishëm prej dt. 18.08.2011.
11. I kontaktuar nga sekretaria pala ankuese kishte deklaruar se kushëriri i tij S., ia kishte shitur pjesën e ngastrën kad. ..., familjes P. e cila sigurisht ja ka shitur palës përgjegjëse ,megjithatë ai është ankuar se pala përgjegjëse e ka ndërtuar shtëpinë në ngastrën kad. ..., e cila sipas tij është e nënës së tij. Sa i përket kërkesës së palës kërkuese nr. 2, pala ankuese kishte konfirmuar se vetëm një pjesë, sipërfaqen prej 078.00ha., të ngastrës së kërkuar ..., i është shitur në vitet e 70-ta, megjithatë kjo sipërfaqe ishte konvertuar në ngastrën kad. ..., (e cila asnjëherë nuk ishte përditësuar në kadastër, në Viti).
12. I kontaktuar nga AKP-ja S. G., i njëjti kishte pranuar duke deklaruar se e ka shitur tërë pronën e cila ishte e tij sipas vendimit për ndarje të vitit 1994, dhe ate katër personave B, P,, M, R,, M,dhe ... (Ž. D.), megjithatë ai nuk e dinte sipërfaqen dhe nga cila ngastër i ishte shitur këtij të fundit.

13. Sekretaria e AKP-së gjatë verifikimit dhe përpunimit të kësaj lënde *ex officio*, sipas Certifikatës së Drejtave Pronësore, (CDP), nr. 3, të dt. 05.03.2011, në kadastrën e Vitisë është gjetur se në të dhënat në kadastrë, paraqitet se daja i palës ankuese, Mina Gojković është pronar i vetëm i ngastrave të kërkuara, gjer sa sipas fletës poseduese nr. 3, të lëshuar nga kadastri i zhvendosur në Serbi paraqitet gjendje tjetër, sipas saj nëna e palës ankuese dhe Mina, janë të regjistruar si bashkëpronarë me nga  $\frac{1}{2}$  pjesë ideale.
14. Sekretaria po ashtu kishte vënë në dukje se kishte mospërputhje të sipërfaqes së ngastrave të kërkuara sipas dokumenteve të ofruara, vendimit të gjykatës për ndarje, dhe fletave poseduese, dhe sipas ndarjes së këtyre ngastrave të cilat në kadastrë nuk ishin të regjistruara si të ndara.
15. Me Vendimin KPCC/D/A/267/2015, të datës 30 Mars 2015, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje: KKPK), e ka refuzuar kërkesën e palës ankuese KPA27076 për pronën lëndore, (ngastrat kad. ... dhe ..., me sipërfaqe të përgjithshme prej 4.00.26ha., e cila gjendet në vendin e quajtur V. Z. Ko, f. ..., sipas Fletës poseduese nr. ...). Në arsyetimin e Vendimit grupor, (paragrafët 58-65), ndër të tjera theksohet se; paraqitësi i kërkesës në mbështetje të kërkesës së tij ka dështuar të paraqes dëshmi të besueshme për të drejtën pronësore para konfliktit të viteve 1998/99, sepse ka mospërputhje në mes të shënimeve në kadastrë në Viti dhe kadastrin të zhvendosur në Serbi. Pronat e kërkuara në kadastrin në Kosovë janë të regjistruara vetëm në emër të M. G.. Po ashtu theksohet se sekretaria e AKP-së-së nuk kishte arritur ti verifikoj si ekzistues asnjërin nga Vendimet gjyqësore andaj nuk ka qen e mundur të verifikoj bazën mbi të cilat nëna e palës ankuese e kishte fituar të drejtën e bashkëpronësisë sipas fletës poseduese të lëshuar në Serbi, andaj fleta poseduese nga arshivat e zhvendosura vlerësohet si jo e saktë, dhe nuk paraqitet si dëshmi valide juridike. Komisioni bazuar në dëshmitë para tij arrin në përfundimin se paraqitësi i kërkesës ka dështuar të dëshmojë të drejtën e tij pronësore, ose çfarë do të drejte tjetër në pronën e kërkuar, menjëherë, para, ose gjatë konfliktit të viteve 1998-99, andaj rrjedhimisht kërkesa duhet refuzuar.
16. Me datë 24 Qershor 2015, Vendimi i KKPK-së, i ishte dorëzuar palës ankuese, Č. M. Me datë 20 Korrik 2015, i njëjti ka ushtruar ankesë kundër tij.
17. Me datë 13. 02. 2015, Vendimi i KKPK-së i ishte dorëzuar palës përgjegjëse Xh. S., ankesë kundër tij nuk ka ushtruar. Me datë 24.06.2016, të njëjtit i është dorëzuar ankesa a palës ankuese për përgjigjtë, përgjigjen në ankesën e palës ankuese e ka paraqitur me datë 20.07.2016.

### **Pretendimet e palës ankuese**

18. Pala ankuese Č. M. vendimin e KKKP-së, e atakon për shkak të: Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
19. Në arsyetimin e ankesës pasi e përshkruan mënyrën e vendosjes si në vendimin e KKKP-së ndër të tjera thekson se; AKP-së i ka ofruar të gjitha dëshmitë (të cekura si më lartë të cilat i bashkëngjit edhe ankesës), si vendimin e trashëgimisë O.br...., të vitit 1953, në bazë të cilit nëna e tij R. me vëllain e saj M. janë bashkëpronarë me nga 1/2, të pronës së kërkuar, ngastrave, nr. ..., nr...., nr...., nr...., nr...., nr...., në sipërfaqe të përgjithshme prej 3.98.40 ha, thekson se kjo gjendje dëshmohet edhe sipas fletës posed. Nr..., lëshuar nga Enti republikan i gjeodezisë së Serbisë, ndërsa në bazë të vendimit të gjykatës të vitit 1994, është bërë ndarja fizike e pronës si në dispozitivin e tij, ndërsa me vendimin e trashëgimisë të vitit 2011, pas vdekjes së nënës së tij, ky është shpallë trashëgimtarë i pronës, që i ka takuar nënës së tij. Vlerëson se arsyetimi i vendimit të ankimuar është i pa qartë dhe kontradiktor edhe pse i është e njohur se në kadastrën në Viti, e tërë prona evidentohet në emër të dajës së tij Mina Gojković, por që kjo gjendje është anuluar sipas Aktgjykimit të Gjykatës Gjilan P.br.221/89, me të cilin nëna e tij Radosava sipas trashëgimisë bëhet bashkëpronare e 1/2, me vëllain e saj Mina, tutje thekson se komisioni ka mundur ti verifikoj këto fakte në Gjykatën Komunale në Viti në të cilën ky nuk ka qasje. Se pala tjetër e paditur, (bëhet fjalë për palën përgjegjëse Xh. Sylejmani), thekson se nuk ka mundur të dëshmoj të drejtën e tij në ngastrën kad. 812, sepse e njëjta është në bashkëpronësi të lartë cekurve dhe pa pëlqimin e tyre ai nuk ka mundur ta bartë këtë pronë, gjer sa shtëpinë e ka ndërtuar në pronë të tyre, etj.
20. Në fund propozon që Gjykata Supreme e Kosovës, të miratoj ankesën e tij dhe të nxjerrë vendim me të cilin të konfirmohet që ai është bashkëpronarë me 1/2, të pjesës ideale të pronës së kërkuar, sipas fletës poseduese nr. ..., Komuna Kadastrale, ...
21. **Pala përgjegjëse në ankesë**, në përgjigjen e tij në ankesën e palës ankuese thekson se, pronën e tij, (nuk e cek ngastrën kadastrale), së pari sipërfaqen prej 10 ari në vitin 2005 e ka blerë nga B. P., pastaj sipërfaqen prej 22.50 ari e ka blerë prej R. M., dhe sipërfaqen prej 20 ari, prej P. P.

#### **Pranueshmëria e ankesës**

22. Ankesa e palës ankuese është e pranueshme sepse është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditë nga dita e pranimit të Vendimit të KKKP, siç është paraparë me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, për zgjidhjen e kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale.
23. Ankesa u shqyrtua në kuptim të nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006, mbi Procedurën Kontestimore, (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008), (në tekstin e mëtejme

LPK), dhe pas shqyrtimit të aktgjykimit sipas pretendimeve në ankesë dhe sipas detyrës zyrtare gjen se, ankesa është e pa bazuar.

### Arsyetimi ligjor

#### *Juridiksioni*

24. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK nr.2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër të Komisionit për ri posedimin e pronës së kërkuar ,nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që duhet të dëshmoj të drejtën e tij pronësore mbi pronën e pa luajtshme private, por gjithashtu duhet të dëshmoj që ai ose ajo tani nuk është në gjendje ta ushtroj këtë të drejtë pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë me ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i cili ka ndodhur në Kosovë ,ndërmjet 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999.
25. Duke u nisur nga pretendimet në ankesë dhe ekzaminimit edhe *ex officio* të Vendimit, në këtë lëndë është e nevojshme të përcaktohet nëse pala ankuese ka paraqitur prova se nëna e tij e ndjerë, apo pas vdekjes së saj, pala ankuese, a ka paraqitur prova se ka qen pronar ligjor i pronës së kërkuar për të vërtetuar të drejtën e tij pronësore, dhe pastaj për tu vërtetuar nëse kjo pronë është humbur si pasojë e rrethanave të konfliktit në Kosovë të viteve 1998/99, prandaj gjykata Supreme do të fokusohet dhe do të japi përmbledhje dhe sqarime lidhur me këtë çështje në këtë drejtim.
26. Sipas KKPK-së, si në vendimin e saj, pretendimeve në kërkesë dhe në ankesë të palës ankuese, vërtetohet se pala ankuese të drejtën e tij pronësore në pronën e kërkuar e mbështetë në Vendimin e trashëgimisë të vitit 1953, sipas të cilit nëna e tij shpallet trashëgimtare me ½ pjesë ideale të pronës së kërkuar me vëllain e saj, mandej Aktvendimin e gjykatës komunale në Viti R.br.134/86 dt. 26.10.1994, për ndarjen e pronës me djemtë e dajës së tij M., Fletën poseduese lëshuar nga kadastrat i zhvendosur dt. 16.04.2002, dhe Aktvendimin e trashëgimisë të dt. 06.07.2011, sipas të cilit pala ankuese shpallet trashëgimtarë i pasurisë pas vdekjes së nënës së tij, andaj pretendon se tani ai është pronarë i pronës së kërkuar.
27. Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe dokumenteve të ofruara të cekura si më lartë nga pala ankuese, gjykata supreme vlerëson se në bazë të tyre nuk dëshmohet e drejta e pretenduar e tij në pronën e kërkuar në ngastrat kad. ..., ... dhe ..., sepse këto dokumente pronësore nga sekretaria e ekzekutive e AKP-së, nuk është arrit të verifikohen pozitivisht si ekzistuese apo si të vërteta në arkivin e gjykatës kompetente, e po ashtu ky organ nuk ka mundur të gjej bazën ligjore për regjistrimin e kësaj prone, në arhivat e zhvendosur kadastral në emër të nënës së tij si bashkëpronare. Në anën tjetër ky organ, *ex officio*, në organin kompetent kadastral në Viti , ka gjetur se prona e kërkuar në bazë të shënimeve kadastrale, ishte e regjistruar vetëm në emër të dajës së palës ankuese Mina , si pronari i vetëm, ndërsa

sipas fletës poseduese të lëshuar nga kadastra e zhvendosur ashtu si u cek më lartë paraqitet gjendje tjetër prona e kërkuar figuron e regjistruar në emër të dy bashkëpronarëve të cekur si më lartë me nga ½, pjesë ideale.

28. Nga gjendja e çështjes si më lartë, në rastet kur e drejta e pronësisë fitohet nga veprimi juridik (bartje ligjore), ashtu si parashihet në nenin 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike, me këtë dispozitë ligjore përcaktohet se në bazë të veprimit juridik, (që në këtë rast konkret është Vendimi i trashëgimisë dhe Vendimi gjyqësor për ndarje të pronës, si pretendon pala ankuese), e drejta e pronësisë mbi pasurinë e pa luajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik, (librin kadastral), ose në mënyrën tjetër përkatëse të përcaktuar me ligj.
29. Gjykata Supreme vlerëson se, nuk provohet me asnjë fakt se Vendimi i Trashëgimisë apo Vendimi gjyqësor lidhur me ndarjen e pronave në Viti, në bazë të cilit pretendon se nëna e tij është bërë pronare e pronës së kërkuar, ishte ekzekutuar ndonjëherë duke u azhuruar në Operatin Kadastral në Kosovë-Viti, në emër të nënës së tij, edhe pse nuk ka pas pengesa juridike apo rrethana të tjera, për tu regjistruar-azhuruar prona në emër të saj si trashëgimtare, duke pasur parasysh se këto akte ishin të lëshuara shumë vite para rrethanave të viteve 1998/99, gjer sa prona e njëjtë në kadastrin në Viti ashtu i u theksua si më lartë nga sekretari e AKP-së, ishte gjet e regjistruar vetëm në emër të pronarit të vetëm M. G.
30. Theksimet e palës ankuese në ankesë dhe dokumentet e ofruara nga ai, të njëjta si ato të theksuara dhe paraqitura në AKP, kolegji i vlerëson se nuk janë të bazuara dhe me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, pala ankuese nuk ofron asnjë provë të re valide apo dokument valid kadastral në bazë të cilit do të dëshmohej e drejta pronësore para periudhës së konfliktit të viteve 1998/99, andaj nga këto fakte konstatohet se nuk ka prova të fitimit të pronësisë në mënyrë ligjore, ashtu si u cek edhe më lartë dhe si parashihet sipas kushteve nga neni 20 dhe 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Pronësore Juridike. Nga kjo gjendje e fakteve realisht dëshmohet se ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar, sepse nuk provohet e drejta pronësore dhe as posedimi i saj i ligjshëm nga pala ankuese në periudhën, para, gjatë apo pas periudhës së viteve 1998/99, në pronën e kërkuar.
31. Prandaj Gjykata Supreme vlerëson se Vendimi i kundërshtuar i KKKPK-së, është marrë me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë edhe ligji material edhe ai procedural janë zbatuar në mënyrën e duhur, me mënyrën e vendosjes duke e refuzuar kërkesën për shkak të mos mbështetjes në dëshmi relevante dhe valide.
32. Sa i përket pretendimeve në ankesë se, Vendimi i goditur është i pa qartë, dispozitivi i tij në kundërshtim me arsyetimin, dhe është kotradiktor me vetveten, Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij pretendimi dhe *ex officio* të vendimit të ankimuar gjen se, Vendimi individual që i referohet kërkesës së palës ankuese me numër KPA27076, megjithatë ishte i përfshirë vetëm me një gabim gjuhësor, i cili nuk ndikon në përmbajtjen e çështjes së vendosur. Në

vendimin individual në gjuhën serbe thuhet se kërkesa ishte “*bedbur*”, kurse në vendimin grupor në të trija gjuhët zyrtare në përdorim dhe si në paragrafin 58-65, të këtij vendimi, që aplikohet në mënyrë specifike për kërkesën e po ashtu në vendimin individual në versionet në gjuhën shqipe dhe angleze thuhet se kërkesa ishte “*refuzuar*”.

33. Sipas dispozitave materiale përcaktohet se në rast mospajtimi apo ndryshimi në mes të versionit në gjuhë angleze dhe versionit në gjuhët e tjera, versioni në gjuhë angleze mbizotëron, bazuar në nenin 3.3, të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5, për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ku parashihet se, “*Kurdo që paraqitet ndonjë dallim apo papajtueshmëri në lidhje me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim ndërmjet verzionit në gjuhën angleze të dokumentit apo vendimit karshi verzionit në gjuhën shqipe apo serbe, fjala, fraza apo interpretimi në gjuhën angleze do të mbizotërojë dhe do të përdoret*”.
34. Prandaj me që vendimi burimor grupor me arsyetim në të trija gjuhët, dhe ai individual në gjuhë burimore angleze dhe gjuhë shqipe figuron se “refuzohet kërkesa”, kolegji vlerëson se nuk është me ndikim përmbajtësor gabimi gjuhësor në vendimin individual në gjuhën serbe, sepse duhet të jetë, “kërkesa refuzohet”, si është në vendimin grupor në të tri gjuhët e jo “kërkesa hedhet”, sepse interpretimi dhe verzioni në gjuhë angleze mbizotëron si origjiner dhe si i tillë përdoret.
35. Ky aktgjykim nuk paragjykon të drejtë pronësore për palët, andaj nuk paraqet pengesë për iniciimin e procedurës pranë organit, apo gjykatës kompetente, për tu shqyrtuar çështja pronësore në baza ligjore nëse palët e gjejnë me interes ligjor.
36. Në bazë të asaj që u tha më lart dhe në përputhje me nenin 13.3 (c), të Ligjit 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë ligjore;**

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm, nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

## **GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**GSK-KPA-A-066-2016, me datë, 15 Janar 2020**

**Bashkp. Profesional,  
Sherif Krasniqi**

**Kryetari i Kolegjit,  
Ragip Namani**



